



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TE JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM
VLORE

Mbi raportet e monitorimit për periudhën
Janar – Prill 2024

Në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, po paraqesim raportin e monitorimit për realizimin e fondeve buxhetore periudhën Janar – Prill 2024, për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Aneksi 1 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve

Buxheti i detajuar për periudhën Janar – Prill 2024 për këtë program është 91,330 mijë lekë dhe realizimi 59,428 mijë lekë ose 65%. Arsyet e këtij realizimi janë:

- Mos realizimi 100% i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për faktin se paguhen nga sigurimet shoqërore punonjëse të cilat janë me leje barre lindje.
- Mos realizimi 100% i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për faktin se ka gjyqtar të shkarkuar të cilët paguhen me 75% të pages, ndërkohë që planifikimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore është bërë mbi numrin plan të organikes.
- Arsye tjetër është detajimi i buxhetit në muajt e parë të vitit në shpenzime personeli dhe mallra dhe shërbime është detajuar me i lartë se nevojat dhe do të përdoret në muajt e tjerë të vitit ku fondi është i pamjaftueshëm.
- Në mallra dhe shërbime kemi një realizim prej 51% pasi disa zera shpenzimesh si karburanti, tonerat, letra që zënë pjesën më të madhe të buxhetit për periudhën Janar – Prill 2024 janë të planifikuara me tender dhe janë akoma në proces prokurimi.
- Në investime nga Buxheti I Shtetit, plani për periudhën Janar – Prill 2024 është 3,000 mijë lekë dhe realizimi është zero përqind. Për vitin 2024 është planifikuar sistem kondicionimi për dhomën e serverit. Procedura akoma nuk ka filluar për faktin se nevojitet specialist i jashtëm në fushën e Data Center (dhomë server) i cili është i domosdoshëm për përcaktimin e specifikimeve. Pas disa ftesave të bëra nga institucioni na është ofruar këto ditë një specialist i fushës dhe jemi në përfundim të hartimit të specifikimeve teknike dhe gati për publikimin e procedurës.

Aneksi 2 - Raporti i Shpenzimeve te programit sipas artikujve buxhetore për periudhën Janar – Prill 2024

Fondet e akorduara per vitin 2024 me Ligjit nr. 97/2023, "Per buxhetin e vitit 2024", për funksionimin e aktivitetit të gjykates, sipas artikujve, paraqiten si më poshtë:

1-Shpenzime Personeli

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën Janar – Prill 2024, për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 79,100 mijë lekë. Realizimi paraqitet në masën 54,719 mijë lekë ose 69% e buxhetit të detajuar.

- Mos realizimi 100% i fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore per faktin se paguhen nga sigurimet shoqerore punonjese te cilat jane me leje barre lindje.
- Mos realizimi 100% i fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore per faktin se ka gjyqtar te shkarkuar te cilet paguhen me 75% te pages, nderkohe qe planifikimi i fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore eshte bere mbi numrin plan te organikes.
- Arsye tjeter eshte detajimi i buxhetit ne muajt e pare te vitit ne shpenzime personeli dhe mallra dhe sherbime eshte detajuar me i larte se nevojat dhe do te perdoret ne muajt e tjere te vitit ku fondi eshte i pamjaftueshem.

2-Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën Janar - Prill 2024 ne fillim te vitit është 9,200 mije leke dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 4,679 mijë lekë ose 51% e buxhetit të detajuar në fillim të vitit.

- Ne mallra dhe sherbime kemi nje realizim prej 51% pasi disa zera shpenzimesh si karburanti, tonerat, letra qe zene pjesen me te madhe te buxhetit për periudhën Janar – Prill 2024 jane te planifikuara me tender dhe jane akoma ne proces prokurimi.

3-Investime

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën Janar - Prill 2024 ne fillim te vitit është 3,000 mije leke dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën zero mijë lekë ose zero e buxhetit të detajuar në fillim të vitit.

- Per vitin 2024 eshte planifikuar sistem kondicionimi per dhomen e serverit. Procedura akoma nuk ka filluar per faktin se nevojitet specialist i jashtem ne fushen e Data Center (dhome server) i cili eshte i domosdoshem per percaktimin e specifikimeve. Pas disa ftesave te bera nga institucioni na eshte ofruar keto dite nje specialist i fushes dhe jemi ne perfundim te hartimit te specifikimeve teknike dhe gati per publikimin e procedures.

Aneksi 3 - Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit


Për periudhën Janar – Prill 2024 jane planifikuar per te mbyllur rreth 2,000 ceshtje dhe rezultojne te perfunduara me vendim gjyqesor 1,579 ceshtje. Pavaresisht numrit plan te gjyqtareve i cili

rezulton i plotesuar, vlen te theksohet se ka gjyqtar te cilet nuk gjykojne per shkak te pezulluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si dhe gjyqtare me leje lindje.

Aneksi 4 – Projektet e investimeve me financim te brendshem

Ne investime nga Buxheti i Shtetit, plani per vitin 2024 dhe konkretisht per periudhen Janar – Prill 2024 eshte 3,000 mije leke. Fondi eshte planifikuar per sistem kondicionimi per dhomen e serverit, e cila eshte ne fazen e hartimit te dokumentacionit per proceduren e prokurimit.

Shef Sektori Buxheti/Financa
Valdete Lelaj



ZV/KRYETAR
Enkel PEZA

